



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

Nr. 2621 Prot.

Vau Dejës, me 22.04.2024

Lënda: Njoftim për mbledhjen e Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Drejtuar: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore" neni 53 pika 4, neni 56 pika 2, neni 57 pika 2 germa c, ju njoftojmë se mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës zhvillohet ditën e Hënë me datë 29.04.2024, ora 14:00. Mbledhja do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Vau Dejës, Njësia Administrative Bushat.

Me këtë rend dite:

1. Projekt vendim për humbjen e mandatit të anëtares së Këshillit Bashkiak Vau Dejës.
2. Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Mars 2024.
3. Projekt vendim për ndryshimin e VKB nr.91 datë 21.12.2023 "Miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe PBA përfundimtar 2024-2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës".
4. Projekt vendim mbi përfundimin e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme familjeve të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019.
5. Projekt vendim për dhënie pëlqimi në parim, për dhënien në përdorim me anë të konkurrimit të sipërfaqes prej 20 ha, pjesë e pasurisë nr.148, Zk nr.2993 e llojit "Kullotë", në fshatin Plezhë, Nj. Administrative Bushat, Bashkia Vau Dejës "Për ndërtim parku fotovoltaik, aerogeneratorë (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj)
6. Të ndryshme

Komisionet e këshillit do mbledhet ditën e Premte, datë 26.04.2024 ora 09.00 pranë Nj.A Bushat.

1. Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut.
2. Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake dhe planifikimit të zhvillimit strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare.
3. Komisioni i mandateve.
4. Komisioni i Siguri së Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit.
5. Komisioni i bujqësisë, pyjeve, menaxhimit të ujërave, mbrojtjes së mjedisit dhe biodiversitetit.

Zv/Kryetari Këshillit

Frano Prenga

